



Fëmijët dhe ekstremizmi i dhunshëm: Standardet dhe përgjigjet ndërkombëtare nga sistemet e drejtësisë penale

Mars 2017

Ky është një ekstrakt nga brifingu i plotë në dispozicion në gjuhën angleze në www.penalreform.org

Ky brifing e jep një pasqyrë të asaj se çfarë thonë standardet ndërkombëtare dhe rajonale në lidhje me kujdesin dhe trajtimin e fëmijëve të cilët janë të dyshuar, apo të dënuar, për vepra të dhunshme ekstremiste. Ai shikon në disa shembuj të intervenimeve shtetërore dhe të shoqërisë civile. Ai trajton parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në ekstremizmin e dhunshëm por në rend të parë është i fokusuar në drejtësinë penale dhe përgjigjen penale ndaj fëmijëve të tillë. Për më shumë informata ju lutemi shikoni në uebfaqen Reforma Penale Ndërkombëtare www.penalreform.org

Përderisa kryerësit e veprave terroriste kanë tendencë të jenë të rinj, ndonjëherë fëmijët (nën moshën 18 vjeçare) gjithashtu kryejnë aktivitete terroriste në shumë cilësi të ndryshme. Në disa kontekste, ata do të vetradikalizohen, në të tjerat ajo është një strategji e qëllimshme për përfshirjen e fëmijëve drejtpërdrejt në akte terroriste.

Kur fëmijët vetradikalizohen, nuk dihet shumë për faktorët që i shtyjnë ata drejt aktiviteteve të ndërlidhura me terrorizmin. Hulumtimet sugjerojnë se në shoqëritë ku mungojnë përfshirja dhe mobiliteti shoqëror, fëmijët dhe të rriturit mund të ndihen të përjashtuar dhe të izoluar nga strukturat politike, ekonomike dhe sociale. Kushtet e tilla, kur ndërlidhen me një ndjenjë të padrejtësisë dhe një tregim historik të viktimizimit, mund të krijojnë një mjedis toksik brenda të cilit mund të lulëzojë ekstremizmi i dhunshëm.

Fëmijët mund të jenë më të prekshëm se sa të rriturit në kërkesën për ekstremizmin e dhunshëm për shkak të mungesës së pjekurisë dhe gjykimit. Ekzistojnë edhe faktorët shtytës të tillë si varfëria dhe zhvendosja si dhe ndjenja e fitimit të një identiteti dhe tërheqja ideologjike. Në shumë raste, janë radikalizuar fëmijët nga familjet e qëndrueshme të cilët janë mirë të arsimuar dhe kanë status të lartë ekonomik. Hulumtimi i të rinjve sirian (të moshës midis 12 dhe 24 vjeç) ka identifikuar katër faktorë kryesorë që kanë shtyrë këtë dobësi ndaj ekstremizmit të dhunshëm:

- Mungesa e mundësive ekonomike
- Konteksti përçarës social dhe përvojat e dhunës. Zhvendosja, trauma dhe humbja
- Heqja e nevojave psikologjike për efikasitet, autonomi dhe qëllim
- Degradimi i infrastrukturës së edukimit dhe mundësive për të mësuar.

Përfshirja e fëmijëve me grupet terroriste është shpesh i pavullnetshëm dhe paraqitet në situatat e konflikteve të armatosura kua ta kanë qenë të rekrutuar si ushtarë fëmijë. Grupet si Boko Haram dhe ISIS i kanë rrëmbyer, kërcënuar dhe detyruar shumë fëmijë t'ju bashkohen atyre.

Fëmijët shpesh janë neglizhuar në nivelin e ligjit dhe politikës kombëtare i cili është shpesh i paqartë rreth asaj se si duhet të trajtohen fëmijët janë të angazhuar në aktivitetet e ndërlidhura me terrorizmin: a duhet ata të trajtohen në të njëjtën mënyrë sikurse të rriturit ? A janë ata shkelës të ligjit fëmijë 'normal'? A janë ata një kategori e veçantë e tyre? Kur duhen dispozitat kundër-terroriste të marrin përparësinë mbi dispozitat ligjore që i mbrojnë fëmijët në konflikt me ligjin? Ka nevojë për më shumë hulumtime për atë se çfarë ndodhë në praktikë me këto grupe të fëmijëve kur ata përpunohen përmes sistemeve të drejtësisë penale. Një boshllëk tjetër i rëndësishëm është kuptimi ynë se si fëmijët mundn më së miri të de-radikalizohen dhe rehabilitohen gjersa gjinden në paraburgim.

Përkundër këtyre mangësive në njohuritë tona, përvoja e Reformës Penale Ndërkombëtare tregon se fëmijët kanë nevojë për mbrojtje të veçantë kur ata janë në konflikt me ligjin. Kjo duhet të bëhet pa marrë parasysh nga pesha e veprës së kryer, nëse janë ata anëtarë të grupeve terroriste apo nëse aplikohen kompetencat e jashtëzakonshme ligjore. Gjithashtu është e rëndësishme që ne pa nevojë të 'ri-zbulojmë rrotën' dhe shumë mësim mund të aplikohet nga përvoja jonë e punës me fëmijë në bandat, apo ushtarët fëmijë të demobilizuar.

Kjo çështje me të vërtetë i ekspozon dobësitë në drejtësi për sistemet e fëmijëve në shumë juridiksione të ndryshme. Ajo që është e rëndësishme është se rreziku dhe rreziqet nga ekstremizmi i dhunshëm nuk bëhet një pretekst për zbutjen e standardeve për fëmijët për fëmijët në konflikt dhe kontakt me ligjin. Në qoftë se e kuptojmë drejtë për fëmijët në këtë fazë të zhvillimit të tyre, është e mundshme për të zvogëluar rrezikun e angazhimit të tyre të mëtejme në ekstremizmin e dhunshëm në të ardhmen.

Rekomandimet kyçe

Në vijim janë disa rekomandime kyçe që dalin nga ky dokument që adresohen në rend të parë për qeverinë:

- Puna parandaluese që stimulon ndjenjën e marginalizimit dhe diskriminimit është kundër-produktive dhe mund të çojë në zhvillimin e tjetërsimit në mesin e të rinjve. Qëllimi i strategjive të parandalimit duhet të zvogëlojë pambrojtëshmërinë e fëmijëve ndaj radikalizimit duke i adresuar kushtet që mund të çojnë në radikalizëm.
- Fëmijët e bashkuar me grupet e armatosura duhet të trajtohen në rend të parë si viktimat dhe të transferohen në autoritetet e mbrojtjes së fëmijëve për rehabilitim.
- Të gjitha përgjigjet ndaj fëmijëve të akuzuar me apo të dënuar për aktivitetet e ndërlidhura me terrorizëm duhen vendosmërisht të bazohen në ligjin ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit. Standardet ndërkombëtare janë parimet e aplikuar në mënyrë universale dhe janë të drejta për të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh peshën apo natyrën e krimit në fjalë.
- Fëmijët e arrestuar dhe akuzuar për vepra terroriste duhet të kenë mbrojtje për moshën e tyre kur intervistohen, arrestohen, gjykohen dhe dënohen, duke përfshirë qasjen në një avokat, dëgjime me kohë, dënime proporcionale, kontaktin me familje dhe miqtë, paraburgim si mjetin e fundit dhe ndarja nga të rriturit në paraburgim.

- Të gjitha pohimet për torturë dhe keqtrajtim ndaj fëmijëve në paraburgim duhet të hetohen dhe ndiqen penalisht në mënyrë të duhur.
- Hulumtimi i mëtejshëm është i nevojshëm për t'i ekzaminuar strategjitë efektive për parandalimin e radikalizmit të fëmijëve në paraburgim por ato duhet të jenë pjesë e një qasjeje të përgjithshme të rehabilitimit dhe re- integritit të. Mjetet për të vlerësuar rrezikun e fëmijëve për të qenë të radikalizuar duhet të vlerësohet me kujdes dhe përshtatet për kontekste të caktuara.
- Fëmijët e dënuar për vepra terroriste, apo të cilët radikalizohen gjatë qëndrimit në paraburgim, duhet të marrin programe të individualizuara për t'ju kundërvënë efekteve të ideologjisë.